

Zegjine Sollaku



GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË
APELIT TIRANË


Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri
Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017

Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite ↻




Pasuria bruto nga fillimi i detyrës deri me
datë 31.12.2017 është rritur 13.1 herë

+ 6,446,093 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete
në Bankë



Pasuritë e
Luajtshme



Pasuritë e
Paluajtshme



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga dhe shpërblime nga funksioni	19,381,380	9.5%
Të ardhura nga puna e familjarëve	28,539,841	14.0%
Të ardhura nga biznesi	153,105,498	74.9%
Te ardhura nga shitja e pasurive te paluajtshme	3,520,100	1.7%
Total	204,546,819	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

1 Me Probleme
13 Pa Probleme

Subjekti Zegjine Sollaku rezulton me burime të pamjaftueshme për të mbuluar shtesën e asetëve në vitin 2013 në shumën 87,675 lekë, pa llogaritur në këtë analizë shpenzimet vjetore për konsum familjar.

Në vitin 2003, subjekti deklaroi një pagesë në vlerën 60,000 USD ndaj një kompanie ndërtimi, për një apartament 3+1 të porositur në vitin 2001. Në vitin 2005, ajo sqaron se pagesa prej 60,000 dollarësh lidhet me blerjen e dy apartamenteve me sipërfaqe 135m² dhe 60m² si dhe një garazhi në Tiranë, prona të cilat vlerësohen në total me 8,682,000 lekë.

Në vitin 2008, subjekti deklaroi pagesën e një kësti të mbetur prej 30,000 eurosh ndaj një kompanie ndërtimi për një apartament, për të cilin shpjegon se e ka deklaruar një vit më parë. Megjithatë, në deklaratën e vitit 2007 nuk rezulton të jetë deklaruar as apartamenti dhe as vlera e plotë e tij.

Në vitin 2016, subjekti deklaroi shitjen e një apartamenti prej 52.3 m² në kompleksin "Xixa" në Golem me vlerë 2,000,000 lekë, i cili nuk rezulton të jetë deklaruar në vitet e mëparshme.

Në vitin 2009 deklarohet një automjet Mercedes Benz në pronësi të subjektit tregtar të bashkëshortit në shumën 42,000 euro, e cila nuk është përfshirë në analizë pasi duhet të pasqyrohet në bilancin e biznesit.

Në vitin 2013, deklarohet kredi bankare në shumën 193,000 euro, e përdorur për blerjen e apartamenteve nga TID shpk si dhe për nevojat e biznesit të bashkëshortit - nuk është e qartë sa është përdorur për biznesin dhe sa për blerjen e apartamenteve.